



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE DHE KONTRATAVE
Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

PROJEKT VENDIM

Nr. 3 datë 23.10. 2023

**“PËR NJË KORRIGJIM GABIMI MATERIAL NË VENDIMIN NR. 62, DATË
26.10.2020 TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E “ PLANIT LOKAL TE
MENAXHIMIT TE MBETJEVE E TE NGURTA URBANE , BASHKIA V AU DEJES
2020-2022”**

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë; Ligji nr 10563, datë 22.09.2019 “ Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar; VKM nr 175 dt 19.01.2011 “ Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”; Udhëzimit nr 1738 dt 12.03.2015 “ Mbi kriteret e studim projektimit për rehabilitimin e vendepozitimeve të trajnimit të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane” , i propozojmë Këshillit të Bashkisë, të:

VENDOSI

1. Korrigjimin e emërimit të vendimit Nr 62 , datë 26.10.2020 të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës dhe pikës 1 të këtij vendimi, si më poshtë :

Ishte: “Për miratimin e “ planit lokal te menaxhimit te mbetjeve e te ngurta urbane , bashkia vau dejes 2020-2022”

Bëhet:

“Për miratimin e “ planit lokal të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane , bashkia vau dejes 2020-2025”

2. Ky korrigjim bëhet për shkak të gabimit material në hartimin e Vendimit nr 62, datë 26.10.2020.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” .

KRYETAR
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETAR

Gjovani Zeff



Pergatiti:

Kristine Shtatri

**Pergjegjes i Sektorit të Asistencës Ligjore,
Çështjeve Gjyqësore dhe Kontratave**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

DATA 23.10.2023

RELACION

“PËR NJË KORRIGJIM GABIMI MATERIAL NË VENDIMIN NR. 62, DATË 26.10.2020 TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E “ PLANIT LOKAL TE MENAXHIMIT TE MBETJEVE E TE NGURTA URBANE , BASHKIA V AU DEJES 2020-2022”

Me projektvendimin nr 03, datë 16.10.2023, nga Sektori i Asistencës Ligjore, Çështjeve Gjyqësore dhe Kontratave , është propozuar miratimi i projektvendimit “ Për miratimin e planit lokal të menaxhimit të mbetjeve e të ngurta urbane, Bashkia Vau Dejës 2020-2025”, bashkëngjitur këtij projekt vendimi ka qenë dhe Plani lokal i menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane për periudhën 2020-2025 dhe relacion i Sektorit , i datës 16.10.2020, ku është përshkruar nevoja për hartimin e këtij plani , detyrat dhe përgjegjësitë, objektivat etj. Ky plan ka qenë i hartuar për një periudhë 5 vjecare, por gjatë hartimit të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, është shënuar gabim periudha, konkretisht 2020-2022.

Për sa më sipër, është e nevojshme që të korrigjohet gabimi material në vendimin nr 62, datë 26.10.2020 , të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, duke u saktësuar periudha e këtij plani siç është në fakt i hartuar plani, 2020-2025.

**SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE, ÇËSHTJEVE GJYQËSORE DHE
KONTRATAVE**

Përgjegjës

Kristinë Shtatri